



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 299, datë 23.12.2020

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS
PËR KANDIDATËT QË KANË KANDIDUAR PËR POZICION DREJTUESI, TË
SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 285, DATË 17.12.2020, I NDRYSHUAR,
TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 159, pika 2 dhe 190, pika 2, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 2-7 të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin nr. 171, datë 27.09.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e Rregullores për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, në nenin 9, pika 4, të Vendimit nr. 200, datë 23.09.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e rregullores mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe me propozimin sipas relacionit të propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale,

V E N D O S I:

1. Të fillojë procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me Vendimin nr. 285, datë 17.12.2020, i ndryshuar, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

- Genti Xholi kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Ludovik Dodaj kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
- Gjon Fusha kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.
- Elizabeta Imeraj kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
- Anita Jella kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
- Kreshnik Ajazi kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
- Violeta Shkurta kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
- Dhorina Theodhori kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.
- Gentian Stoja kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

- Petrit Çano kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.
- Rita Gjati kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.
- Rita Gjati kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.
- Farije Vata kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.
- Arben Dyla kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë.
- Erion Shehaj kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.
- Abaz Muça kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat.
- Dorina Bejko kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.
- Lorenc Mërkuri kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
- Sali Hasa kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
- Albert Murcaj kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.
- Arben Smaçi kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.
- Arben Nika kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin.
- Erion Çela kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
- Albert Kuliqi kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
- Aurel Zarka kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

2. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore për ndjekjen e këtij procesi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ESMERALDA KESHI